

**STATUT**  
**i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar**  
**“Legacy Consulting & Service”**

**Kreu I**  
**Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja**

**Neni 1**

**Data e themelimit, Emri, Themeluesit.**

1. Sot me date 06.08.2018 ne themeluesit, kemi krijuar, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me emrin “Legacy Consulting & Service” shpk.

2. Themeluesit e Shoqërisë:

- **Erol Aydin**, lindur me 08.05.1963, ne Perseme dhe banues ne Turqi, identifikuar me pasaporte me nr U 00283113.

- **Celal Demir**, lindur me 01.11.1966 ne Erzurum dhe banues ne Turqi, identifikuar me pasaporte me nr U 01049837.

- **Arjan Xhaho**, atësia Jorgaq, i datëlindjes 04.06.1987, identifikuar me nr personal I70604101V, lindur në Fier dhe banues në: Liqeni i Thatë, Rruga “Peti”, Pallati “Konadi”, Kati 1, Apt 2, Tiranë, Shqipëri.

- **Dario Memlika**, atësia Gezim, i datelindjes 12.08.1995, lindur ne Tepelene dhe banues ne Tirane, identifikuar me nr personal J50812080Q.

**Neni 2**  
**Objekti**

1. Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm: Zhvillim biznesi, keshillim dhe sherbime.

**Neni 3**  
**Kohëzgjatja**

1. Shoqëria është krijuar për një periudhë kohe të pacaktuar.

2. Vendimet, për shpërbërjen e hershme të shoqërisë, merren me vendim të Asamblesë së Ortakëve 30 ditë para vendosjes për shpërbërje.

**STATUTE**  
**Of Limited Liability Company**  
**“Legacy Consulting & Service”**

**Chapter I**  
**Establishment, Name, Object, Duration**

**Article 1**

**Date of establishment, Name, Founders**

1. Today on date 06.08.2018 we the founders have created, a company with limited liability, with the name “Legacy Consulting & Service” Ltd.

2. Company founders:

- **Erol Aydin**, born on 08.05.1963, in Perseme and resident in Turkey, identified through passport with no U 00283113.

- **Celal Demir**, born on 01.11.1966 in Erzurum and resident in Turkey, identified through passport with no U 01049837.

- **Arjan Xhaho**, father’s name Jorgaq, born on 04.06.1987, identified with personal no I70604101V, in Fier, and resident in Liqeni i Thatë, Rruga “Peti”, Pallati “Konadi”, Kati 1, Apt 2, Tirana, Albania.

- **Dario Memlika**, father’s name Gezim, born on 12.08.1995, in Tepelene and resident in Tirana, identified with personal no J50812080Q.

**Article 2**  
**Object**

2. The company shall exercise the following activity: Business Development, Consulting and service.

**Article 3**  
**Duration**

1. The company has been established for an unlimited period of time.

2. The decisions for the early dissolution of the company are taken by a decision of the Assembly of Partners 30 days before the settlement for dissolution.

**Neni 4  
Selia**

1. Selia e regjistruar e shoqërisë ndodhet në adresën: Njesia 10, Rruga “Kavajes” Qendra “Sun Tower” Kati X, Apartamenti 30, Tirane.

**Kreu II  
Kapitali**

**Neni 5  
Kapitali Themeltar**

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 1000 Lekë.

1. Ortaku themelues, **Erol Aydin** është zotëruar i një quote, me vlerë të përgjithshme 310 Lekë, që përbën 31% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

2. Ortaku themelues, **Celal Demir** është zotëruar i një quote, me vlerë të përgjithshme 300 Lekë, që përbën 30% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

3. Ortaku themelues, **Arjan Xhaho** është zotëruar i një quote, me vlerë të përgjithshme 290 Lekë, që përbën 29% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

4. Ortaku themelues, **Dario Memlika** është zotëruar i një quote, me vlerë të përgjithshme 100 Lekë, që përbën 10% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

5. Te nënshkruarit kane kontribuar per kompanine si me poshte :

Kontribut monetarë:

**Erol Aydin** 310 Leke

**Celal Demir** 300 Leke.

**Arjan Xhaho** 290 Leke.

**Dario Memlika** 100 Leke.

Kontribut të mirash të ndryshme

- s'ka

kontribut në natyrë

- s'ka

**Article 4  
Head Office**

1. The registered head office is at the address: Unit 10, “Kavaja” Street, “Sun Tower” Center, X floor, Apt 30, Tirana.

**Chapter II  
Capital**

**Article 5  
Initial Capital**

The initial capital of the company is 1000 ALL.

1. Founder Partner **Erol Aydin** is the owner of a quote of 310 Lek, which constitutes 31% of the company's initial capital.

2. Founder Partner **Celal Demir** is the owner of a quote of 300 Lek, which constitutes 30% of the company's initial capital.

3. Founder Partner **Arjan Xhaho** is the owner of a quote of 290 Lek, which constitutes 29% of the company's initial capital.

4. Founder Partner **Dario Memlika** is the owner of a quote of 100 Lek, which constitutes 10% of the company's initial capital

5. The undersigned has contributed to the company as follows:

Monetary Contribution

**Erol Aydin** 310 Lek

**Celal Demir** 300 Lek.

**Arjan Xhaho** 290 Lek.

**Dario Memlika** 100 Leke

Contribution to various benefits

- no

contribution to nature

- no

### **Neni 6**

#### **Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit**

- 1.Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet, nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para, dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet vendimit të Asamblesë së Ortakëve.
- 2.Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga Asambleja e Ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.
- 3.Në të gjitha rastet, zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë, ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

### **Neni 7**

#### **Transferimi i Kapitalit**

- 1.Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, e të drejtat që rrjedhin prej tyre, mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
  - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - b) shitblerjes;
  - c) trashëgimisë;
  - ç) dhurimit;
  - d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- 2.Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme, por duke ezauruar si procedure fillestare të drejtën e parablerjes.

### **Kreu III**

#### **Organet Vendimmarrëse dhe Drejtuese**

### **Neni 8**

#### **Organi Vendimmarrës**

- 1.Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
- 2.Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë, që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.
- 3.Asambleja e Ortakëve, është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:
  - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;

### **Article 6**

#### **Increase and Decrease of the Capital**

- 1.The capital of the company may be increased through the signatures of the initial capital parts for cash contributions, and through contributions in nature, through the decision of the Assembly of Partners.
- 2.The capital decrease is permitted by the Assembly of Partners, which makes the decision under the same conditions as are required for the amendment of the Statute.
3. In all cases, the decrease affects the partners to the same extent, to the capital parts that they represent.

### **Article 7**

#### **Capital Transfer**

1. Capital quotes of a limited liability company and the rights deriving from them may be obtained or passed through:
  - a) contribution to the capital of the company;
  - b) sale;
  - c) inheritance;
  - ç) donation;
  - d) any other manner provided by law.
- 2.Initial capital parts are freely transferable, but exhausting the initial right of pre-emption.


### **Chapter III**

#### **Decision-making and Leading Bodies**

### **Article 8**

#### **Decision-making Body**

- 1.The Assembly of Partners is the sole decision-making body of the company.
- 2.The Assembly of Partners is the sole decision-making body of the company, which approves any change of the statute according to the modalities set forth in the law.
- 3.The Partner's Assembly is responsible for making decisions about the Company on following issues :
  - a) determining the company's trade policies;
  - b) statute changes;
  - c) appointment and dismissal of administrators;
  - ç) the appointment and dismissal of authorized



ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;  
d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;  
dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;  
e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;  
ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;  
f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;  
g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;  
gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;  
h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;  
i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

4.Ortaku mund të përfaqësohet në Asmablenë e Ortakëve, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër ose nga një person i tretë.

5.Administratori, nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në Asamblenë e Ortakëve.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Ortakëve, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njejtin rend dite.

#### Neni 9

##### **Mënyra e thirrjes së Asamblesë së Ortakëve**

1. Asambleja e Ortakëve, thirret, nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik, duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës, e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë, përpara datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë.

2. Kur Asambleja e Ortakëve nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm, nëse të gjithë ortakët janë dakord për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

liquidators and accounting experts;  
d)determining the remuneration for the persons mentioned in letters "c" and "ç" of this point;  
dh)overseeing the implementation of trade policies by the administrators, including the preparation of annual financial statements and progress reports of the activity;  
e)the approval of the annual financial statements and the progress reports of the activity;  
h) increase and decrease of the capital;  
f) division of quotas and their cancellation;  
g) representation of the company in court and other proceedings against the administrators;  
gj)reorganization and dissolution of the company;  
h)approval of procedural rules of assembly meetings;  
i) other issues provided by law or statute.

4.The Partner may be represented on the Assembly of the Partners, on the basis of an authorization from another partner or by a third party.

5. The Administrator can not act as a representative of Partners in the Assembly of Partners.


Authorization can be granted only for a meeting of the Assembly of Partners, which includes the next meetings with the same agenda.

#### Article 9

##### **The way of calling the Assembly of Partners**

1. The Assembly of the Partners shall be called by written notice or by e-mail notification. The notice by letter or electronic mail must contain the place, date, time of meeting and agenda, and be sent to all partners no later than 7 days before the date foreseen for the Assembly meeting.

2. When the Assembly of Partners is not called under point 1 of this Article, it may take Valuable decisions, only if all partners agree to make any decisions, regardless irregularity.



**Neni 10  
Kuorumi**

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur Asambleja e Ortakëve duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të “Ligjit për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” ajo mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

2. Nëse Asambleja e Ortakëve nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit, të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri, jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

**Neni 11  
Marrja e Vendimeve**

1. Asambleja e Ortakëve, vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

2. Për çështjet e tjera të përmendura në nenin 8, Asambleja e Ortakëve, vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

3. Cdo ndryshim statuti duhet të regjistrohet në QKB, për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

**Neni 12  
Përfshirja nga e drejta e votës**

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votes, nëse Asambleja e Ortakëve merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënieve ose jo të përfitimeve të reja.

2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në

**Article 10  
Quorum**

1. In the case of making decisions requiring an ordinary majority, the Assembly of Partners may take valid decisions only if eligible voting partners own more than 30 percent of the quotes. When the Assembly of Associates has to decide on matters requiring a qualified majority pursuant to Article 87 of the “Law on Traders and Commercial Companies”, it may take valid decisions only if the partners owning more than half the total number of votes, are personally present, vote by letter or electronic means, according to the provisions of point 3 of Article 88 of this law.

2. If the Assembly of Partners can not meet due to the lack of quorum, referred to, in paragraph 1 of this article, the Assembly is convened again, not later than 30 days, with the same agenda.

**Article 11  
Decision's Making**

1. The Assembly of Partners shall decide by three-quarters of the votes of the participating partners, amend the statute, increase or decrease the registered capital, distribute profits, reorganize and dissolve the company.

2. For other matters referred to in Article 8, the Assembly of Partners shall decide by majority of the votes of the participating partners.


3. Any statute change should be registered at National Business Center to reflect changes to the company's file.

**Article 12  
Exemption from the right to vote**

1. The Partner can not exercise the right to vote if the Assembly of Partners makes a decision on:

- a) Assessment of its activity;
- b) termination of any obligation under its responsibility;
- c) filing a lawsuit against him by company;
- ç) whether or not to grant new benefits.

2. When a partner is represented by an authorized representative, the authorized




të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortakun, të cilin përfaqëson.

**Neni 13**  
**Administrimi**

1.Asambleja e Ortakëve, emëron si administratore Z. **Erol Aydin**, me nr identifikimi U 00283113, Z. **Celal Demir** me nr identifikimi U 01049837, dhe Z. **Arjan Xhaho** me nr identifikimi I70604101V, te cilet mund ta perfaqesojne shoqerine se bashku ose vec e vec ne marredhenie me te tretet, për një afat 5 vjecar, me të drejtë rizgjedhje.

Nënshkrimi

  
Erol Aydin  
Celal Demir  
Arjan Xhaho

**Neni 14**  
**Kompetencat e Administratorit**


1.Administratori ka të drejtë e detyrohet të:  
a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e ortakëve;  
b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;  
c) kujdeset për mbajtjen e saktë, e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;  
ç) përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara Asamblesë së Ortakëve për miratim;  
d) krijon një sistem paralajmërimi, në kohën e duhur, për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;  
dh) kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;  
e) raporton përpara Asamblesë së Ortakëve, në

person is deemed to be in the same conflict of interest as the partner he represents.

**Article 13**  
**Administration**

1. The Assembly of Partners appoints as Administrators Mr. **Erol Aydin**, with identification no U 00283113, and Mr. **Celal Demir** with identification no U 01049837, and Mr. **Arjan Xhaho** with identification no I70604101V which can represent the company together or separately in the relationship with the third parties, for a period of five years, with the right of re-election.

Signature

  
Erol Aydin  
Celal Demir  
Arjan Xhaho

**Article 14**

**Administrator Competences**

1.The Administrator has the right and obligation to:

- a) perform all actions of the administration of the commercial activity of the company, by applying trade policies, established by the partners' assembly;
- b) Represent the commercial company;
- c) takes care of the accurate and regular keeping of company documents and books;
- d) prepare and sign the annual balance sheet, consolidated balance sheet and progress report of activity and, together with proposals for the distribution of profits, submits these documents to the Assembly of Partners for approval;
- d) Establishes a timely warning system for the circumstances that threaten the progress of the activity and the existence of the company;
- dh) Performs registrations and sends the compulsory data of the company, as provided in the law on the National Business Center;
- e) reports to the Assembly of the Partners regarding the implementation of commercial



lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme, me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryen detyra të tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.

2.Administratori është i detyruar të thërrasë Asamblenë e Ortakëve kur:

- sipas bilancit vjetor, apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme, brenda 3 muajve në vazhdim.

- shoqëria propozon të shesë, apo të disponojë në mënyrë tjetër, aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

- brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak, pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

3.Asambleja e Ortakëve mund të shkarkojë administratorin në cdo kohë me shumicë të zakonshme.

### Neni 15

#### Kufizime te kompetencave te Administratorit

1. Secili nga Administratorët ka te drejte te nenshkruaje marreveshje, realizoje transaksione, te beje terheqje deri ne nje shume prej 1000 Euro.

2. Veprimet qe kane te bejne me shuma nga 2000 -5000 Euro, duhet te kryhen me firmat e dy administratoreve.

3. Per veprime me vlere mbi 5000 Euro, duhet firma e tre administratoreve qe te jene te vlefshme.

4. Kontrat/ para kontratat, marreveshjet/para marreveshjet, qe nuk jane te lidhura me nje vlere monetare duhet te firmosen nga te tre adminisitraret, ose nga njeri prej tyre, i autorizuar nga dy te tjeret.

policies and the execution of special actions of special importance for the commercial company;

è) performs other duties, as defined by law and statute.

2. The Administrator is obliged to call the Assembly of Partners when:

- According to the annual balance sheet or the interim financial reports, there is a risk that the assets of the company will not cover the required liabilities within the next 3 months.

- the company proposes to sell, or dispose otherwise assets that have a value higher than 5 percent of the company's assets resulting in the latest certified financial statements.

- within the first 2 years after its registration, proposes to buy from a partner, assets that have a value higher than 5 percent of the company's assets, resulting in the latest certified financial statements.

3. The Partners' Assembly may discharge the Administrator at any time by an ordinary majority.

### Article 15


#### Limitations of Administrator Competences

1. Each of Administrators has the right to sign agreements, make transactions, withdraw up to an amount of 1000 Eur.

2. Actions which needs amounts 2000-5000 Eur, must be carried out with the signature of two administrators.

3. For actions over 5000 Eur, in order to be valid is necessary the signature of three administrators.

4. Contracts,/pre contracts, agreements/pre-agreements, not related with a monetary amount, must be signed from three administrators, or one of them authorized by the two others.



### Neni 16

#### Përgjegjësitë e Administratorit

1. Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

2. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme për besnikërinë, sipas neneve 14, 15, 17, e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" administratori detyrohet:

a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj, ose në statut, në mirëbesim, e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj, ose në statut, vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi, çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të garantojë miratimin e marrëveshjeve, sipas dispozitave të pikës 3 të nenit 13 të këtij ligji;

dh) të ushtrojë detyrat e tij, me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat, dhe shkel standartet profesionale të caktuara më sipër, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, si dhe të kalojë cdo përfitim që ai apo persona të lidhur me të, kanë realizuar nga këto veprime të parregullta.

4. Administratori është përgjegjës, edhe për cdo detyrim tjetër, që nuk është parashikuar shprehimisht në këtë statut, por që rrjedh nga ligji "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

### Neni 17

#### Viti Financiar

1. Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar, dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit

### Article 16

#### Administrator Responsibilities

1. The administrator is individually liable, to the company or to third parties, for violation of laws, for violation of the statute, or for faults committed during the administration of the company.

2. In addition to what is provided in the general loyalty provisions, according to Articles 14, 15, 17, and 18 of the Law "On Traders and Commercial Companies" the administrator is obliged:

a) to carry out his duties set out in law or statute, in good faith, and in the best interests of the company as a whole, paying particular attention to the impact of the activity of the company on the environment;

b) to exercise the powers recognized by law or statute only for reaching the goals defined in these provisions;

c) to evaluate responsibly, the issues for which a decision is taken;

ç) to prevent and avoid cases of conflict, present or potential, of personal interests with those of the company;

d) to guarantee the approval of agreements, in accordance with the provisions of point 3 of article 13 of this law;

f) to carry out his duties, with the professionalism and necessary care.


3. If the administrator acts in contravention of the duties and violates the professional standards set out above, he or she is obliged to compensate the company for damages and to pass any benefits that he or any person connected to him have carried out such irregular actions.

4. The Administrator is also responsible for any other obligations that are not provided for in this Statute but deriving from the Law "On Traders and Commercial Companies".

### Article 17

#### Financial Year

1. The financial year of the company begins on 1 January, and ends on 31 December. Exceptionally, the first financial year starts on





të shoqërisë në QKB, dhe përfundon më 31 Dhjetor.

**Kreu IV**  
**Prishja/Riorganizimi i shoqërisë**

**Neni 18**  
**Prishja/Likuidimi i Shoqërisë**

1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet, dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë, në përputhje me pikën 3 të nenit 43, të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

2. Në këtë rast ortakët marrin vendim me shkrim, në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një ose disa likuidatorë.

3. Nëse ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar, mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

**Neni 19**  
**Riorganizimi i Shoqërisë**

1. Shoqëria mund të ndahet, bashkohet, sipas vendimit të mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore, të parashikuara në pjesën IX të ligjit, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

**Neni 20**  
**Baza ligjore**

1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj, në përputhje me këtë statut, dhe legjislacionin shqiptar.

2. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të

the date of registration of the company at the National Business Center, and ends on 31 December.

**Chapter IV**  
**Dissolution/ Reorganization of the Company**

**Article 18**  
**Dissolution / Liquidation of the Company**

1. The limited liability company breaks down:

- (a) when the duration foreseen in its establishment expires;
- b) by decision of the General Assembly;
- c) opening of bankruptcy proceedings;
- ç) if it has not been engaged in commercial activity for two years, and has not been notified of the suspension of activity in accordance with point 3 of Article 43 of Law No.9723, dated 3.5.2007, "On the National Registration Center";
- d) by a court decision;

2. In this case, the partners make a written decision, which provides for the liquidation of the company by assigning one or more liquidators.

3. If the partners do not make a decision on the appointment of the liquidators, within 30 days after the dissolution, any interested person may address to the court to appoint a liquidator.


**Article 19**  
**Reorganization of the Company**

1. The Company may be divided, join, according to the decision of the Assembly of Partners, in accordance with the legal provisions provided for in Part IX of the Law "For Traders and Commercial Companies".

**Article 20**  
**The Law**

1. The Company shall conduct its activity in accordance with this Statute, and the Albanian legislation.

2. For the purposes of this Statute, shall apply




zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Kodit Civil dhe cdo ligj tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 21**  
**Mosmarrëveshjet**


1.Për mosmarrëveshjet që mund të lindin, për zbatimin e interpretimin e këtij statuti, si dhe cdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis shoqërisë dhe të tretëve, do të jenë kompetente gjykatat shqipëtare.

**Ortaket e Shoqërisë me Përgjegjësi të kufizuar**  
**"Legacy Consulting & Service"**


Erol Aydin




Celal Demir



Arjan Xhaho



Dario Memlika



Perktheu: Elisabeta Nezaj


the provisions of the Law "For Traders and Commercial Companies", the Civil Code and any other specific law in the Republic of Albania.

**Article 21**  
**Disputes**

1.For disputes that may arise, for the implementation and interpretation of this Statute, as well as any disagreement that may arise between the company and the third parties, the Albanian courts shall be competent.

**Partners of the Limited Liability Company**  
**"Legacy Consulting & Service"**

Erol Aydin




Celal Demir



Arjan Xhaho



Dario Memlika



Translated by : Elisabeta Nezaj